

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje pajisje mobileri për arsimin bazë shkolla 9-vjecare “Avni Rustemi” në Bashkinë Tepelenë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39112000-0 –

VLERA E FONDIT LIMIT:

3.578.647 (tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë,) leke pa tvsh;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, shkresa nr 1668/2 ,datë 07.03.2024 e MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT / Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve mbëshjtetëse /Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme , me karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”. autoriteti/enti kontraktor **“Bashkia Tepelenë .** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 1073594(një milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros te jete ne masen **1073594(një milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) Leke.**

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 715730 (shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën afërsisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afërsisht 20 % të vlerës së fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar, për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorin si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jodiskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, për mallrat që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme, duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet e leshuara nga një organ i autorizuar:

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i produktit</i>	<i>Vendi i origjinës</i>	<i>Certifikate konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent i akredituar</i>
<i>1</i>			
<i>2</i>			

3			
4			
5			
6			

Argumentimi: Kerkesa per paraqitjen e deklarates se konformitetit per produktet qe kerkohen me siper, eshte nje kerkese e lidhur ngushtesisht me objektin e kontrates dhe duke qene se, Autoriteti Kontraktor eshte perfitues direkt i kontrates objekt prokurimi eshte ne te drejten e tij te garantohet se OE-te pjesemarres i plotesojne kerkesat e cilesise se mallit qe do te ofertohej, rrjeshimisht eshte e drejte e AK-se tu kerkoje ofertuesve qe te paraqesin deklarate per te vertetuar konformitetin prodhimit te produkteve te procedures e prokurimit. Per Autoritetit Kontraktor eshte e nevojshme qe, Operatoret ekonomike gjate ofertimit te tyre te provojne se zoterojne kapacitetet teknike lidhur me deklaraten e konformitetit per artikujt e kerkuara me siper. Kerkesa e mesiperme ka si qellim te siguroje AK-ne, mbi aftesite teknike te OE fitues ne drejtim te permbushjes me sukses te kontrates dhe detyrimeve ne zbatim te saj, konform standarteve te mirepercaktuara ne DST. Ky kriter nuk eshte diskriminues dhe eshte proporcional me objektin e kontrates, si dhe eshte ne zbatim te Nenit 44, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituar nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe ka lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:*

➤ *ISO 9001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Certifikata per menaxhimin e cilesise ISO 9001: eshte referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e OE ofertues dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike (të perkthyer dhe noterizuar) për mallrat objekt prokurimi. Në katalog/skede teknike, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu/Skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se: Mallrat objekt procedure prokurimi janë të reja dhe të pa përdorura me parë.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues, në datën dhe orën e hapjes së kësaj procedure, duhet të paraqesë nga një monster për secilin nga artikujt e kërkuar për këtë procedure prokurimi dhe konkretisht për:*

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Tavolina nxenesi cikli ulet (120x64x45 cm)	copë	1
2	Karrige nxenesi cikli ulët (35x38x37/70 cm)	copë	1
3	Tavolina nxenesi cikli i lartë (120x75x45 cm)	copë	1
4	Karrige nxenesi cikli lartë (35x38x42/75 cm)	copë	1
5	Tavolina mesuesi (120x60x76 cm) cikli i lartë, arsimit i mesëm	copë	1
6	Karrige për mesues me tapiceri (510x450x780 mm)	copë	1
7	Dollap për klasë	copë	1

8	Derrasë e zezë (120x180 cm)	copë	1
9	Karrige për kabinetet	copë	1
10	Tavolina për kabinet dyshe 120x60x72 cm)	copë	1
11	Dollap për kabinetet e kimisë dhe biologjisë	copë	1
12	Dollap për kabinetet e fizikës	copë	1
13	Tavolina nxënësi dyvendëshe për kompjuter- Arsimi i Mesëm	copë	1
14	Tavolina e mësuesit për kabinetin e informatikës	copë	1
15	Karrige për nxënës për kabinetin e informatikës	copë	1
16	Tavolina për bibliotekë	copë	1
17	Rafte biblioteke	copë	1
18	Karrige biblioteke	copë	1
19	Tavolinë drejtuesi në formë L (e madhe)	copë	1
20	Tavolinë drejtuesi në formë L (e vogël)	copë	1
21	Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie	copë	1
22	Tavolinë zyre	copë	1
23	Raft/Dollap për zyra	copë	1
24	Karrige zyre e thejeshte (510x450x780 mm)	copë	1
25	Tavolinë mbledhjeje e madhe (240x120x75 cm)	copë	1
26	Karrige për sallën e mësuesve	copë	1
27	Portmonto për dhomën e mësuesve	copë	1
28	Rafte për çdo mësues në sallën e mësuesve	copë	1
29	Dollap garderobë për stafin	copë	1
30	Tavolinë për sallë polifunksionale	copë	1
31	Karrige për sallën polifunksionale	copë	1
32	Dollap për arkivin (90x40x195 cm)	copë	1
33	Raft për infermierinë	copë	1
34	Shtrat vizite për infermierinë	copë	1

Mosparaqitja e monstrave konsiderohet si kusht për skualifikim.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 *Lidhur me mostrat e paraqitura nga OE ofertues, Autoriteti Kontraktor mund të perzgjedh nje/disa/mallrat dhe do ti dergoje per analiza, prane nje laboratorit te akredituar ne Republiken e Shqiperise, per treguesit fiziko-mekanik e tekstil, te perdorur nga prodhuesi per te vertetuar pajtueshmerine me specifikimet teknike te kerkuara.*

Per te permbushur kete kriter, OE ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku jep: miratimin per kryerjen e analizave, te dhenat e kontaktit, ne menyre qe te kontaktohet dhe te jete i pranishem ne momentin e perzgjedhjes se mostrave dhe dergimit te tyre prane laboratorit.

Mosparaqitja e kesaj deklarate si me siper, per kryerjen e analizave laboratorike, konsiderohen si kushte per skualifikim.

Argumentimi: Ky kriter është hartuar, në mënyrë që vlerësimi i mallrave të bëhet sa më i saktë dhe duke qenë se mostrat e paraqitura nuk mund të vlerësohen në përbërjen e tyre në kushtet e punës në AK, vlerësimi i ofertave do të mbështetet në analizat teknike laboratorike të bëra nga institucione të akredituara. Kriteri i kërkuar në lidhje me analizën e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/c, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.9 *OE ofertues duhet te disponoje te pakten 3 punonjes, per nje periudhe te pakten 3(tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat e-Sig per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për aftësinë e OE ofertues për të patur punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës, është bërë duke patur në konsideratë sasinë e lëvrimit dhe afatin e dorëzimit të mallrave. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE, si dhe në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit,

Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 5/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.10 Ne funksion të plotesimit të Shtojces 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar prej MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT / Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve mbështetëse /Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme , shkresa nr 1668/2 ,datë 07.03.2024, me karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

NJESIA E PROKURIMIT